

VENDIM
Nr. 57 , datë 29.12.2017

**PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 13, DATË 30.3.2017, “MBI TARIFAT E UJIT PËR KONSUM PUBLIK
PËR SHOQËRINË
UK BERAT - KUÇOVË”**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 13, datë 30.3.2017, “Për tarifën e ujit për konsum publik për shoqërinë UK Berat - Kuçovë sh.a., bëhen ndryshimet e shtesat e mëposhtme:

- a) Në pikën 1, pas pikës “b” shtohen pikat “c”, “ç” dhe “d”, si më poshtë:
- c) Tarifën volumetrike

Kategoria e shërbimit	Njësia	Njësitë administrative	
		Otllak, Velabisht, Sinje, Kozare, Lumas	Roshnik
a) Për shërbimin e furnizimit me ujë			
1. Konsumatorë familjarë	lekë/m ³	50	40
2. Konsumatorë publikë	lekë/m ³	150	150
3. Konsumatorë privatë	lekë/m ³	150	150
b) Për largimin e ujërave të ndotura			
1. Konsumatorë familjarë	lekë/m ³	14	14
2. Konsumatorë publikë	lekë/m ³	24	24
3. Konsumatorë privatë	lekë/m ³	24	24

- ç) Tarifa e shitjes së ujit me shumicë
Për UK Poliçan: 5.4 lekë/m³

- d) Tarifa fikse

Kategoria e konsumatorëve	Njësia	Njësitë administrative	
		Otllak, Velabisht, Sinje, Kozare, Lumas, Roshnik	
1. Konsumatorë familjarë	lekë/m ³		100
2. Konsumatorë publikë	lekë/m ³		200
3. Konsumatorë privatë	lekë/m ³		200

- b) Pika 2 e vendimit ndryshon si më poshtë:

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2018 janë si më poshtë:

Treguesit e performancës	Viti 2018
Mbulimi me ujë	78%
Mbulimi me kanalizime	62%
Niveli i matjes	67%
Uji pa të ardhura	65%
Norma e arkëtimit	86%

2. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2018 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Ndriçim Shani

